

**PERMBLEDHJE E RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS PER  
AKTIVITETIN:**

**INDUSTRIA MINERARE “NYJE FRAKSIONIMI DHE LARJE INERTESH, LINJE E  
PRODHIMEVE TE BETONIT (PLLAKAVE, PARAFABRIKATEVE, TUBAVE, BLOQEVE  
PALETAVE ETJ ) DEPOZITIM TE TYRE, VEPRIMTARI TE KATRANIT DHE BITUMIT:  
FABRIKE ASFALTO BETONI, ZYRA , OFICINE, MAGAZINE ETJ. PER NEVOJA TE  
MAQINERIVE TE KANTJERIT TE PRODHIMIT”**

**SUBJEKTI “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” SH.A.  
VENDI AKTIVITETIT: RRETHI ELBASAN, KOMUNA BRADASHESH , FSHATI BALEZ**

**SHKURT 2015**

## **PERMBAJTIA E LENDES**

### Hyrje

1. Baza ligjore ku mbeshtetet veprimtaria e projektit.
  - a. Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (V.N.M-se.) .Objektivat e V.N.M-se, Politikat dhe Strategjite. Metodika.
  - b. Pershkrimi i vendodhjes se veprimtarise shoqeruar me harten ilustruese dhe fotografi nga objekti.
    - b.1. Plani i ndertimit dhe afatet e tije.
    - b.2. Pershkrimi i veprave inxhinjerike dhe veprave te domosdoshme per zbatimin e projektit.
    - b.3. Infrastruktura e rrjetit elektrik.
    - b.4. Rrjeti i furnizimit me uje dhe kanalizimeve.
  - c. Pershkrimi i proceseve teknologjike;
    - c).1. Arsyet per perzgjedhjen e sheshit .
    - c.2. Pershkrimi i instalimeve dhe teknologjise se projektit.
      - c.2.1. Pershkrimi i sistemit te shfrytezimit .
      - c.2.2. Tipet e mjeteve dhe mekanizmave qe parashikohen per ngarkim dhe transport.
      - c.2.3. Procesi teknologjik i prodhimit dhe karakteristikat e tij.
        - c.2.3.1. Impianti i fraksionimit dhe procesi i perpunimit te materialit inert.
        - c.2.3.2. Sitosja e lendes se pare ne siten me dy kate
        - c.2.3.3. Copetimi i materialit inert ne fronto.
        - c.2.3.4. Fraksjonimi i materialit nepermjet sistemit te sitosjes(8).
        - c.2.3.5. Procesi i therrmimit se materialit ne mullinj (21)(22).
        - c.2.3.6. Procesi sitosjes pas bluarjes se materialit ne mullinj.
          - c.2.4.1. Impianti i prodhimit te betonit.
          - c.2.4.2. Procesi i prodhimit te betonit.
      - c.2.5. Lendet e para.
      - c.2.6. Furnizimi me energji elektrike
      - c.2.7. Furnizimi me uje teknologjik.
      - c.2.8. Materialet- Perberesit e betonit.
    - d. Informacion per cilesine e ajrit dhe ujerave siperfaqsores ne zonen e veprimtarise ku do te kryhen shkarkimet ne mjedis
    - e. Ndikimet e veprimtarise se shfrytezimit te objektit sipas fazave te ushtrimit te veprimtarise. Identifikimi i ndikimeve ne mjedis te aktivitetit.
    - f. Masat per kapjen dhe trajtimin e ndotjes dhe shkarkimeve ne mjedis . Identifikimi i masave per te eliminuar apo zbutur ndikimet negative ne mjedis. Masat zbutese te ndikimeve negative gjate procesit te shfrytezimit.
    - i. Plani i menaxhimit te mbetjeve (te elementeve me ndikim ne mjedis) ne perputhje me kerkesat e ligjit 10463, date 07.07.2011, "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve".
    - j. Programi i vetmonitorimi te shkarkimeve ne mjedis

## **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

## Hyrje

Rajoni i Shqipërisë Qendrore ku bën pjesë dhe zona e Bradasëshit, e zgjedhur për ngritjen dhe funksionimin e linjës për prodhimin e larjës së inerteve të ndërtimit me baze furnizimi inertet lumore dhe ato shkembore, linjës së prodhimit të betonit-prodhimit të pllakave të betonit, parafabrikateve prej betoni; prodhimeve të ndryshme prej betoni, fabrika e asfalto betonit si dhe infrastrukturen mbështetëse të sajë (oficine, magazine, zyrë etj) nga subjekti "Rruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan" sh.a. është ndërhapësirat e rëndësishme dhe me të vlefshme të vendit, e parë nga ky kënd vështrimi, nga ai i zhvillimit ekonomik dhe vlerave mjedisore që ajo paraqet.

Në zhvillimin ekonomik-shoqëror të një vendi, gjithënjë në përputhje me parimet universal të zhvillimit të qëndrueshëm, marrin një rëndësi të vecantë gjetja e rrugëve dhe teknologjive me efikasë, si për shfrytëzimin sa më rracional të pasurive natyrore, ashtu dhe për kontrollin cilësor dhe sasior të ndikimit në mjedis.

Gjatë dekadave të fundit veprimtari të ndryshme kanë ndikuar dukshëm në mjedisin rrethues në përgjithësi.

Shkarkimet e lengeta urbane dhe industriale në ujrat sipërfaqësore janë tashmë një dukuri e rëndësishme, të cilat në mënyrë progresive kanë ndikuar në demtimin e cilësive së ujërave të lumenjëve të tane. Këto ndikime shpesh herë të njohura por dhe të pa njohura, janë të dukshme në impaktin që kanë në shëndetin e njeriut dhe mjedisin në përgjithësi.

### **1. Baza ligjore ku mbështetet veprimtaria e projektit.**

Ekspertët e studios janë mbështetur në bazën ligjore mjedisore të listuar më poshtë në zgjedhjen e teknologjisë dhe instalimit të saj. Shoqëria zotohet të zbatojë me korrektesë të gjithë këto baze ligjore, V.K.M., rregullore të ndryshme si dhe të adoptojë aktivitetin e saj me bazën ligjore të re nëse behen ndryshime. Ligjet baze janë:

- Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011, "Për lejet e mjedisit";
- Ligji Nr. 10431, datë 09.06.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit";
- Ligji Nr. 10 463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve";
- Ligji Nr. 8766, datë 05.04.2001, "Te mbrojtjes ndaj zjarrit";
- Ligji Nr. 9010, datë 13.02.2002, "Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta";
- Ligji Nr. 9108, datë 17.07.2003, "Për substancat dhe preparatet kimike";
- Ligji Nr 8770 dt 19/04/2001 "Për shërbiminë ruajtës dhe sigurisë fizike";

- Ligji Nr 8756, date 26.03.2001 “Per mbrojtjen nga zjarri”;
- Ligji Nr.9244, date 17.06.2004 “Per mbrojtjen e tokes bujqesore”;
- Ligji Nr.9385, date 04.05.2005 “Per pyjet dhe sherbimin pyjor”;
- Ligji Nr.9587, date 20.07.2006 “Per mbrojtjen e biodiversitetit”;
- V.K.M.Nr.419, date 25.06.2014” Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjediosre te tipeve A, B dhe C, per transferimin e lejeve nga nje subjekt tek tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit, si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja”;
- V.K.M. Nr.417, date 25.06.2014, ”Per miratimin e tarifave te lejeve te mjedisit”;
- V.K.M.Nr.435, date 12.09.2002,“Per normat e shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise”;
- V.K.M. Nr.1189, date 18.1.2009,“Per rregullat dhe procedurat per hartimin dhe zbatimin e programit kombetar te monitorimit te mjedisit”;
- V.K.M. Nr.177, date 31.03.2005, “Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritesa”;
- V.K.M.Nr.765, datë 7.11.2012”Per miratimin e rregullave per grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave te perdorura”;
- Vendimi Nr.99, datë 18.02.2005 i Këshillit të Ministrave, “ Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve ”;
- V.K.M.Nr.587, date 07.07.2010,“Per monitorimin dhe kontrollin e nivelit te zhurmave ne qendrat urbane dhe turistike”;
- V.K.M.Nr.13, date 14.01.2013 ”Per miratimin e rregullave, afateve dhe pergjegjsive per informimin dhe pjesmarjen e publikut gjate procesit te vleresimit te ndikimit ne mjedis”;
- Udhezimi Nr.8, date 27.11.2007,“Per nivelet kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara;
- Udhezimi Nr.429, date 17.11.2009, i Ministrit te Mjedisit, “Per rregullat dhe procedurat per paisjen me leje mjedisi ne kuader te Qendres Kombetare te Licensimit”;
- Udhezimi Nr.6527 date 24/12/2004, “Mbi vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit ne mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuara nga mjetet rrugore dhe mynyrat e kontrollit te tyre”;

- Rregulloren Nr.1, date 15.03.2006, "Per parandalimin e ndikimeve negative ne shendet e ne mjedis te veprimtarive ndertimore";
- Rregullore Nr. 1, date 30.03.2007, „Per trajtimet e mbetjeve te ndertimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjesimi i tyre“.

Projekti zbatohet gjithashtu edhe ne perputhje me ligjet dhe aktet nenligjore per urbanistiken dhe organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

#### **a).Qellimi i veprimtarise**

Projekti i propozuar per tu pajisur me Leje Mjedisore Tipi A ka si qellim funksionimin e linjes per prodhimin e larjen e inerteve te ndertimit me baze furnizimi inertet lumore e shkembore ,( fraksionimi i inerteve sipas permasave dhe grimtesise se kerkuar, duke prodhur ne kete menyre rere natyrale te dale nga frantoja, rere te grimtezuar me makineri bluarje, zhavor te dimensioneve te ndryshme sipas kerkesave te ndertuesve) linjes se prodhimit te betonit-prodhimit te pllakave te betonit, parafabrikeve prej betoni; prodhimeve te ndryshme prej betoni; prodhimit te asfalto betonit si dhe infrastrukturen mbeshtetese te tyre( oficine, magazine, zyra etj) nga subjekti "Rruga Ura Asfaltim Nr.2"sh.a. Per nje funksionim sa me optimal dhe me cilesi qe synohen te ofrohen, jane ndertuar objektet dhe infrastruktura e cila do mbeshtese aktivitetin e mesiperm. Investitori po zhvillon prej vitesh kete veprimtari , ka mjetet e nevojshme teknike dhe nje staf te caktuar posacerisht per kete veprimtari , ka si synim ruajtjen e shtreterve te lumenje dhe guroreve sipas ligjeve, akteve ligjore dhe nenligjore , urdheresave dhe udhezimeve per kete synim , mbajtjen paster te rrugeve dhe shesheve perberese te tij , mbrojtjen e jetes dhe te shendetit te njeriut si dhe mbrojtja e mjedisit ne' zbatim te ligjeve te dala ne vite per te minimizuar ndotjet. Ky subjekt eshte ne perputhje te plate me Ligjin Nr.III/20 12 , date15.11.2012 "Per menaxhimin e integruar te burimeve ujore", Nenin 44, Shfrytezimi i materialeve inerte i cili percakton : Organet e menaxhimit te burimeve ujore leshojne leje administrative per shfrytezimin e materialeve inerte, si rere , zhavorr , qe nxirren nga shtreterit e lumenjve , perrenjve , liqeneve me ose pa uje , vetem ne qofte se plotesohen kushtet dhe kriteret ligjore, te percaktuara me akte nenligjore.

Ky raport eshte hartuar per te identifikuar ndikimet negative ne mjedis te kesaj veprimtarie dhe propozimet per masat zbutese te tyre. Duhet thene se specialistet e

studios mjedisore kane pasur per baze Ligjin Nr.10440, date 07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe aktet e tjera normative qe lidhen me te"; Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011, "Per Lejet e Mjedisit", neni 8 "Kërkesat e përgjithshme për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit A", pika 2" E njëjta leje mjedisi e tipit A mund të lejojë funksionimin e më shumë se një instalimi të të njëjtit operator në të njëjtën vendndodhje"; shtojce 1, pika 3.1/"d" dhe "e"; pika 3.7 dhe 3.10, pika 7.3./b.

#### **a).1. Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM)**

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis eshte nje proces sistematik per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar. Ne nje situatë normale, ky proces aplikohet perpara se te merren vendimit dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Por sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e VNM. Kujdes i veçante i kushtohet praktikave te V.N.M. per te parandaluar dhe minimizuar efektet e mundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte :

- Te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te veprimeve te propozuara.
- Te promovojë zhvillimin miqësor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis .

#### **Objektivat e V.N.M.-se**

Objektivat e V.N.M. ndahen ne dy kategori. Qellimi i pare, drejtperdrejte, eshte te informoje procesin e vendimarrjes duke identifikuar e konsiderueshme potenciale ne mjedis dhe rreziqet e perfitimet e projektit dhe zhvillimit te propozuar. Qellimi perfundimtar, afatgjate i V.N.M. eshte te promovojë zhvillimin e qendrueshem duke siguruar qe propozimet e projektit nuk demtojne burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesen e komunitet si dhe te njerezeve qe lidhen apo varen nga ky projekt ose aktivitet.

*Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te V.N.M:*

■ Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit;

■ Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me eficence;

■ Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projekt apo propozimit;

■ Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.

*Objektivat afatgjate te V.N.M. jane:*

■ Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;

■ Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit;

■ Ruan dhe mbron burimet natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;

■ Permiroson aspektet sociale te projektit .

Qellimi i ketij Raporti te Vleresimit ne Mjedis te pergatitur per kete subjekt, eshte qe te indentifikoje pasojat e mundeshme negative mjedisore qe mund te krijohen si gjate hapjes por edhe gjate shfrytezimit te ketij aktiviteti.

Gjithashtu nje synim tjeter eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike - organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zvillimit te aktivitetit.

Ne shfrytezimin e linjes (nyjes) per prodhimin e larjen e inerteve te ndertimit me baze furnizimi inertet lumore e shkembore, ( fraksionimi i inerteve sipas permasave dhe grimtesise se kerkuar, duke prodhur ne kete menyre rere natyrale te dale nga frantoja, rere te grimtezuar me makineri bluarje, zhavor te dimensioneve te ndryeshme sipas kerkesave te ndertuesve) linjes se prodhimit te betonit-prodhimit te pllakave te betonit, parafabrikateve prej betoni; prodhimeve te ndryshme prej betoni dhe asfalto betoni si dhe infrastrukturen mbeshtetese te saje ( oficine, magazine, zyra etj) nga subjekti "Ruga Ura Asfaltim Nr.2 Elbasan" sh.a. , shoqeria do te marre te gjitha masat per zbatimin me perpikmeri te projektit te hartuar qe ai te siguroje nje zhvillim normal te procesit te prodhimit pa demtuar mjedisin.

Aktiviteti i subjektit te siperpermendur eshte ndermerre si nje inisiativ qe do te tentoje pervec rritjes se fitimit te investitorit edhe ne :

- Shfrytezimin dhe perdorimin e lendes se pare ne vend.

- Rritjen e punesimeve ne zonen perreth.
- Permisimin e sistemit rrugor ne nivele lokale.

Shfrytezimi i linjes per prodhimin e larjen e inerteve te ndertimit me baze furnizimi inertet lumore e shkembore, ( fraksionimi i inerteve sipas permasave dhe grimtesise se kerkuar, duke prodhur ne kete menyre rere natyrale te dale nga frantoja, rere te grimtezuar me makineri bluarje, zhavor te dimensioneve te ndryshme sipas kerkesave te ndertuesve) linjes se prodhimit te betonit-prodhimit te pllakave te betonit, parafabrikeve prej betoni; prodhimeve te ndryshme prej betoni dhe prodhimi te asfalto betoni si dhe infrastrukturen mbeshtetese te saje ( oficine, magazine, zyra etj) nga subjekti "Rruga Ura Asfaltim Nr.2" sh.a.. ka çuar ne disa raste ne prishjen e ekuilibrave natyrore, per shkak te nje shfrytezimi pa kriter dhe pa rregulla sipas nje ligjeshmerie te caktuar shkencore.

**b.)Pershkrimi i vendodhjes se veprimtarise shoqeruar me harten ilustruese dhe fotografi nga objekti.**

Veprimtaria ushtrohet ne Fshatin Balez te Komunes Bradashesh, ne afersi te rruges Kusarth-Balez ne afersi te kufirit ndares me fabriken e cimentos(ECF).

**b.2.Pershkrimi i veprave inxhinjrike dhe veprave te domosdoshme per zbatimin e projektit.**

Ne hapesiren e territorit ku do te zhvillohet veprimtaria eshte instaluar teknologjia qe sherben per ushtrimin e veprimtarise si dhe eshte ndertuar infrastruktura e sherbimeve mbeshtetese te operacioneve. Nder njesite dhe veprat kryesore te projektit jane:

- Nyja e fraksionimit dhe larjes se inerteve(lumore dhe shkembore) ;
- Linja e prodhimit te betonit dhe elementeve te tij ;
- Fabrike e prodhimit te asfalto betonit;
- Sheshi depozitimit te materialit;
- Parkimi i automjeteve;
- Peshorja;
- Magazina;
- Oficina;



- Zyra e kantjerit ;
- Linja e prodhimit te pllakave, parafabrikateve, tubave dhe elementeve te tjere prej betoni .

Krahas tyre eshte ndertuar

- 1.Sistemi i kanalizimeve dhe parandalimit te ndotjes se mjedisit, puseta dhe kanale mbledhes te ujrave.
- 2.Sistemi i mbrojtjes kundra zjarrit, fikse zjarri portative, kosha metalike , tabela sinjalizuese, rezervar uji i lidhur me nje pompe qe siguron uje me presjon ne te gjithë ambjentet e punes.
- 3.Sistemi i rrjetit elektrik, telefonik dhe atij hidrik per ushtrimin e veprimtarise.
4. Sistemi rrugor.

### **c). Pershkrimi i proceseve teknologjike.**

#### **Impianti i fraksionimit dhe procesi i perpunimit te materialit inert.**

Shoqeria "Rruga Ura Aslatim Nr.2 Elbasan"sh.a. ka investuar per aplikimin e nje teknologjie bashkekohore te standarteve europiane te prodhimit. Ky impiant se bashku me impiantet e tjere(betonit, asfalto betonit, prodhimit te pllakave ) eshte teper eficient persa i takon perdorimit te energjise, pjeseve teknologjike te ndryshme te saj ndertohen ose modifikohen me te reja, shpikje te reja inxhinjerike te cilat permiresojne eficencen dhe optimizojne perdorimin e energjise dhe ndikimin e tij ne mjedis.

Pershkrimi i procesit teknologjik te punes.

Materialet inerte qe do te perdoren per prodhimin e betonit sipas klasave te ndryshme do te jene te cilesise se larte dhe konform kushteve te ciesise per keto produkte. Inerti qe do te perdoret eshte i lare dhe do te perdoret nga karierra qe disponon subjekti ne te njejten vendodhje me impiantin e betonit dhe te fraksionimit. Materiali qe sherben si lende e pare transportohet i lare dhe perpunohet ne linjen e fraksionimit. Pasi transportohet materiali i marre prej karierrës depozitohet ne zonen e depozitimit te lendes se pare te impiantit te fraksionimit te gurit gelqeror. Lenda e pare e cila perbehet nga gure te diametrave te vegjel, kalon ne impiantin e fraksionimit i cili ka nje proces pune ne pranine e ujit, ku kryhet larja dhe me pas bluarja e gurit. Guri gelqeror pasi eshte lare kalon ne mullirin bluares ku kryhet regjistrimi i permasave te gurit qe duhet te dale nga ky proces dhe sipas llojit dhe diametrit te gureve lenda e gatshme ndahet ne disa zona depozitimi, ku me pas ngarkohet ne kamiona per tu transportuar ne pikat ku kryhen punime dhe nje pjese e ketij materiali perdoret si lende e pare per linjen e prodhimit te betonit dhe

asfaltobetonit ne kete kantier. Sipas porosive te ndryshme per produktin e gatshem vihen ne pune edhe makinerite e prodhimit te tyre, si psh. Prodhimi i betonit dhe asfaltobetonit eshte sipas porosive. Per prodhimin e betonit ne kete kantier ndodhet nje impiant i posacem i cili perbehet nga tre depozita te ruajtjes se granilit dhe reres dhe nje sillose per depozitimin e cimentos. Sistemi i drejtimit te impiantit ndodhet ne nje kabine e cila eshte elektronike me parametra bashkekohore.

**Prodhimi i betonit realizohet sipas skemes se me poshtme:**

Raporti per te prodhuar beton eshte 1(C):2(R):4(Z-Ca) ndersa uje eshte raporti  $u/\zeta=0.6$  pra per nje kapacitet mesatar prej  $100\text{m}^3/\text{h}$ , arrijme ne perfundimin se ketij impianti do ti duhen rreth 48t cemento, 96t rere, 192t cakell apo zall, ndersa uje rreth  $29\text{m}^3/\text{h}$ . Ne lidhje me ngarkimin dhe transportin eshte parashikuar qe pajisjet do te perbehen nga makina ngarkuese, kamion vetshkarkues, etj. Kjo zgjidhje behet per shkak te adaptueshmerise dhe fleksibilitetit te larte qe kane keto lloj pajisje, shkalles se larte te disponueshmerise, si dhe mundesine per ti kombinuar ato per te realizuar punime te ndryshme sipas nevojave te prodhimit. Nevojat per ngarkim percaktohen nga numri i kamionve te nevojshem qe varen nga distanca e transportimit, disponueshmeria per pune e makinave ngarkuese dhe e kamionve, oret e punes ne dispozicion per dite/turn, etj. Koha ne dispozicion per ngarkim eshte 7 ore/turn ose dite. Koha e nevojshme per nje cikel te plote te makines ngarkuese per te ngarkuar materialin nga pirgu me materiale ne kamion eshte 60 minuta. Koeficienti i mbushjes se koves se makines ngarkuese zakonisht eshte 80%.

Nyja e fraksionimit te inerteve

Nyja thyerse perbehet nga :

- Thyeresi me nofulla; Mulliri; Sitat; Transportjeret; Laresia e gurit skaema paraqitet me poshte.

**Pershkrimi dhe Volumet** e Punimeve Punimet konsistojne ne transportim, depozitim dhe perpunim te gurit gelqeror dhe inerteve lumore per prodhimin e materialeve te ndertimit dhe betonit. Punimet e instalimit konsistojne ne transportimin e paisjeve si sillosa, elektromotorra, elektropompa, transportier, mulliri prerjes se gurit, profile te ndarjes se vend-depozitimitt e inerteve, mjete rrethuese, depozita uji, etj.

Kjo linje teknologjike sipas proceseve qe realizon perbehet nga keto njesi baze:

Bunkeri i depozitimitt te materialeve inerteve qe vijne nga lumi ose nga linja e perpunimitte inerteve shkembore qe ka subjekti ose nga furnitore te trete.



7. Larese rere S=15 m<sup>2</sup>
8. Site me dy kate S=10 m<sup>2</sup>
9. Transportier L=21 metra
10. Fronto
11. Site me dy kate S=2 m<sup>2</sup>
12. Pompe uji Q=4 m<sup>3</sup>/min
13. Transportier L=21 metra
14. Site me dy kate S=6 m<sup>2</sup>
15. Transportier L= 20 metra
16. Transportier L=16 metra
17. Transportier L=20 metra
18. Site me dy kate S=6 m<sup>2</sup>
19. Transportier L=21 metra
20. Transportier L=10 metra
21. Mulli 60 x 40 cm
22. Mulli 40 x 40 cm
23. transportier L=23 metra
24. Bunker dozatore 20 m<sup>3</sup>
- A. Pult komandimi 5 x 3 metra
- B. Kabine elektrike 7 x 3 metra

#### c.2.4.1. Impianti i prodhimit te betonit.

Teknologjia e prodhimit te betonit eshte teknologji e thjeshte e standarteve europiane.

Produkte te ketij impianti do te jete betoni i markave te ndryshme sipas kerkesave te tregut. Linja e prodhimit ka nje kapacitet prodhues variabel dhe punon me cikel te mbyllur. Produkti i ketij impianti do te furnizoje industrine e ndertimit ne zone e me gjere.

Ne baze te fraksioneve inerte te perdorura, raporteve midis tyre dhe aditiveve te lidhjes se granulave (cimento) ne kantier do te prodhohen si me poshte: Masa volumetrike relative e betonit te prodhuar do te jete 2371 Kg/m<sup>3</sup>.

Rere %	Granil 1 -2 %	Cimento (kg)	Marka e betonit
40%	60%	220	M - 100
40%	60%	270	M - 150
40%	60%	295	M - 200
40%	60%	355	M - 350

#### c.2.5. Lendet e para.

Lenda e pare qe perdoret per prodhim te materialeve inerte per ndertim jane kryesisht materiale inerte qe merren nga lumi dhe qe perfaqesojne materiale me konsistence zhavori apo rere. Nderkohe ne linje perdoren dhe lende te para te siguruar nga gurorja qe ka vete subjekti dhe qe perbehen nga shkembinj karbonike.

### **-Lendet inerte lumore ose shkembore**

Te dhenat e shkurtera mbi perberjen e materialeve lumore jane pak a shume si me poshte

Permbajtia Mineralogjik e Agregatit

Klasat	+2.5mm (0.2%)	+1,25 mm (0.3%)	0.63 mm (15%)	+0.32 mm (60%)	+0.15mm (25,5%)
Copa karbonate	-	-		35%	36%
Copa Ranore	30%		22%	20%	15%
Gelqerore	25%	28%	32%		
Kalcit	3%	-	5%	5%	10%
Kuarc i paster	10%	12%	12%	15%	18%
Copa dru/qymyr	2 %	-			
Agregat shkemb.	30%	-	28%	20%	20%
Agreg.magmatik	-	30%			
Agreg.ranor	-	30%			
Mika	-	-	Deri 1%		Deri 1%

### **Fabrika e prodhimit te asfalto betonit**

Teknologjia e prodhimit të asfalto betonit tashmë është e përhapur mjaft edhe në Shqipëri dhe përfaqëson në vetvete një përzierje homogjene të bitumit tipi III me material inert të granular me dimensione të caktuara i tharë në furrën cilindrike në temperaturën 130-140°C kjo për arsye të largimit 100 % të lagështirës nga materiali inert. Mbas furrës granili përzihet me bitumin në homogjenizator dhe prej aty kalon në bunker.

Bitumi që do përdoret për prodhimin e asfalto betonit do të ketë këto të dhëna fiziko-kimike:

- pesha specifike - 1,06 gr/cm<sup>3</sup> ;
- pika e flakërimit (me metoden e kroxholit të hapur) 232°C;
- pika e zbutjes 50°C;
- duktiliteti në 25°C në cm jo më pak se 40;
- penetracioni po në 25°C 41-70 njësi;

Materiali inert mund të jetë i ndryshëm granil nga gurë shkëmbor, zhavorr të dimensioneve të caktuara e të lara.

Lënda djegëse që përdoret për mbajtjen e temperaturës së sistemit mund të jetë e gaztë ose e lëngët. Lënda djegëse e gaztë mund të jetë gaz i lëngëshëm, që me një impiant gazi mund të jetë i manovrueshëm për t'u përdorur për ngrohjen e furrës së tharjes së granilit. Si lëndë djegëse e

lëngët mund të përdoret solari ose gazoili D2, por në këtë rast duhet të merren masa për mbrojtjen e mjedisit nga ndotjet e gazrave, që çlirohen gjatë djegies.

Pajisjet kryesore që përdoren në skemën teknologjike janë:

1. bunkere për granilin;
2. rezervuarët e bitumit;
3. furra për tharjen e materialit inert;
4. homogjenizues;
5. bunkeri i grumbullimit të asfalto betonit (paraprak);
6. bunkeri i asfalto betonit përfundimtar;
7. pajisjet teknologjike për ngrohjen e bitumit dhe solarit;
8. tubacione dhe saracineska të ndryshme me dhe pa termoizolim;
9. filtri për pastrimin e gazrave dhe pluhurave;
10. pompat e lëndës djegëse dhe të bitumit;
11. rezervuare uji dhe shkume.

### **Funksionimi i skemës teknologjike**

Impianti i prodhimit të asfalto - betonit do të vihet në punë mbas kolaudit të pajisjeve, makinerive, tubacioneve, armaturave, rrjetit elektrik dhe rrjetit rezervë (gjeneratorë), si edhe mbas sigurimit të lëndëve të para dhe materialeve ndihmëse, uji teknologjik dhe ai zjarrfikës.

Procesi fillon me parangrohjen e rezervuarit të bitumit deri në temperaturën 130 – 140 oC (kjo në funksion të kartës teknologjike të impiantit). Ngrohjet furra për tharjen e granilit ose zhavorrit të copëtuar në dimensione të caktuar. Mbas arrihen parametrat e kërkuara të cilat kontrollohen nga operatori i sallës së komandimit, fillon e vihet në punë transportieri i granilit, si edhe transportieri i çarjes së inertit në furrë. Kështu fillon furnizimi i furrës cilindrike, e cila duke u rrotulluar i jep nxehtësinë e duhur granilit për të hequr komplet lagështirën dhe pluhurin nga materiali inert. Në fund të furrës granili përzihet me bitum të tipit-III dhe bashkë me të kalon në elevatore që luan rolin e homogjenizatorit. Këtu bëhet homogjenizimi i masës së asfalto betonit. Nga homogjenizuesi asfalto betoni ngrohtë kalon në parabunker, ku bëhet çlirimi i gazeve dhe evitimi i flluskave të ajrit.

Mbas kësaj pajisjeje, asfalto betoni hidhet në një shnek transportues dhe përfundon në bunkerin e produktit të gatshëm, nga ku prej aty shkarkohet në automjete për në destinacion. Gjithë operacioni kontrollohet nga operatori i sallës së komandës dhe punonjësit sipas vendeve të punës. Në impiant instalohen edhe pajisje që shërbejnë për ngrohjen e bitumit dhe për çarjen e gazoilit në dhomën e djegies.

Për pastrimin e gazrave dhe pluhurit që çlirohet nga granili, shërben filtri i vendosur në fund të impiantit. Mbas filtrit gazrat kalojnë në oxhak.

### **Informacion për shkarkimet në mjedis.**

Shkarkimet në mjedis gjatë funksionimit të impiantit të prodhimit të betonit do të jenë kryesisht pluhuri i lëndës pare si granil dhe rere, si dhe zhurma e impiantit dhe në rast të mundshëm derdhje të cimentos në sheshin e prodhimit. Procesi i prodhimit të betonit përfshinë edhe përdorimin e ujit, si pjesë e procesit teknologjik, kjo shërben për tretjen e cimentos dhe furnizimin e autobetonierëve me ujë për procesin e lagës së materialit të perzier. Proces tjetër është edhe larja e pastrimi i autobetonierëve pas shkarkimit të betonit, në mënyrë që të mos ngrihet material në depozitën e perziersit të betonit. Këto ujëra do të jenë me cimento. Për këtë arsye, drejtuesit e këtyre mjeteve duhet të trajtohen për të kryer këtë proces në kantierin e prodhimit, vaskën e dekantimit dhe jo në çdo mjedis të mundshëm. Procesi i linjës fraksionimit përfshinë përdorimin e ujit por vetëm për larjen e materialit dhe uljen e pluhurit gjatë procesit të fraksionimit dhe transportimit të materialit. Uji është me cikël të mbyllur dhe kalon nëpërmjet një vaskë dekantimi, mbetjet e vaskës janë në trajtë llumrash dhe menaxhohen si mbetje të ngurta. Për humbjet e ujit gjatë procesit të punës dhe avullimit, shtohet ujë nga sistemi furnizimit me pus. Cilësia e ajrit dhe ujërave sipërfaqësore në zonën në vlerësim Për zonën të dhënat e monitorimit të cilësive së mjedisit paraqiten në nivele të kënaqshme. Janë kryer matje të elementeve të mjedisit të zonës nga Ministria e Mjedisit dhe operatorët industriale, duke u nisur nga fakti i vendodhjes së shumë aktiviteteve, mund të vlerësohet një mjedis disi i ndotur nga pluhuri dhe lenda e ngurte në pezulli. Nuk vlerësohet ndotje kimike.

Identifikimi i burimeve ujore në afërsi të aktivitetit Në afërsi të aktivitetit, nuk identifikohen burime ujore, si rrjedhojë për plotësimin e nevojave është hapur një pus. Burimi ujor më i rëndësishëm i zonës është perroi I balzes, i cili kalon në distancë të largët nga sheshi në vlerësim. Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes së zonës në vlerësim Sipërfaqja bimore e zonës është barishtore dhe pjesërisht pyjore, e përbërë nga pisha të buta. Përberja e tokës është shkëmbore dhe nuk është shumë e pasur me bimesë.

## **IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS TË AKTIVITETIT**

### **Te përgjithshme**

Mjedisi është gjithmone i prekur nga veprimtaritë e ndryshme që ushtrohen në të, por ndikimi mund të jetë i ndryshëm, kjo është e lidhur ngushtë me vetë llojin e veprimtarisë e cila mund të ketë impakt të drejtperdrejtë, të terthortë, të rëndësishëm apo mesatar i pranueshëm. Një nga

objektivat e këtij raporti është identifikimi i ndikimeve të mundshme që mund të shkaktohen në mjedis nga ky aktivitet në teresi. Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin e kësaj zone do të vlerësohen në njërin prej fazave kryesore; faza e funksionimit, pasi nuk përfshihen procese ndërtimi në këto kantier. Nuk marrim në konsideratë fazën pas përfundimit të veprimtarisë pasi ky aktivitet do të vazhdojë të jetë i tillë në vazhdimësi. Ky aktivitet nuk prek zonë me bimesë, ndodhet në brendësi të sheshit të karrigeres të miratuar për shfrytëzim. Disa prej ndikimeve kryesore që janë vlerësuar si të mundshme janë paraqitur si më poshtë.

### **Vlerësim i impakteve kryesore në mjedis**

Vlerësimi i ndikimeve në mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes së mjedisit të cilat janë: Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit Parimi i qasjes së integruar Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit Parimi “Ndotësi paguan” Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit Ky vlerësim kryhet në bazë të ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” dhe VKM Nr. 13, datë 04.01.2013 dhe ka si synim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

- a) parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdo lloji;
- b) ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c) ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d) përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e) ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f) mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
- g) mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Sa më sipër vlerësimi i ndikimeve në mjedis do të vlerësojë:

Ndikimet në ajër

Ndikimet në ujë

Ndikimet në tokë

Ndikimet në biodiversitet (mjedisi biologjik)

Ndikimet në mjedisin social-ekonomik

Ndikimet që shkaktojnë ndryshimet klimatike



## **Ndikimet e pritshme ne mjedis**

Ndikimet e analizuara gjate fazes se funksionimit te aktivitetit mund te permbliidhen sipas elementeve te mjedisit, si me poshte:

### **Shkarkimet ne ujera**

Shkarkimet ne ujera vijne nga:

- a) Pastrimi i ambientit ne rast te shkarkimit te cimentos se lengshme, kryesisht nga nderprerja e punes per shkak te nderprerjeve te energjise elektrike ose avari te tjera.
- b) Ne rastet e pastrimit te automjeteve te transportit ne ambientin e kantierit, larja e autobetoniereve dhe e materialit te gurit gelqeror.
- c) Ujerat e lagies se sheshit te qarkullimit te automjeteve.
- d) Ujerat e perodur per ambientet higjenosanitare te ambientit te stafit
- e) Ujerat nga shplarja e materialit nga rreshjet.

Lidhur me ujerat qe vijne nga perdorimi sanitar, ato nuk duhet te perzihen me ujrata industriale, por duhet te kalojne ne sistem kanalizimi dhe te lidhen me kolektorin e zones. Gjithashtu ujerat industriale, mbas proceseve te ndarjes ne dekantim duhet te kalojne ne sistem te mbyllur me riqarkullim, ose pas dekantimit te tyre nga lenda e ngurte ne pezulli, mund te shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones. Nuk duhet te shkarkohen ne lum, ne gjendjen fillestare te tyre, pa kaluar ne sistem trajtimi. Duke marre ne konsiderate respektimin e kushteve teknike ne kete objekt, mundesite e ndotjes nga rastet e emergjencave jane te rralla. Ujerat e pastrimit te ambientit dhe mbetjeve ose produktit, duhet te trajtohen ne vasken e dekantimit paraprakisht para se te shkarkohen ne mjedisin e zones. Nuk duhet te shkarkohen ne mjedisin e zones pa u trajtuar paraprakisht. Ndikimi i ketij aktiviteti ne ujera konsiston ne ujerat e pastrimit te ambientit te punes. Procesi teknologjik, sipas relacionit te paraqitur dhe deklarimit te investitorit, nuk perfshine perdorimin e ujit. Ndikimi nuk eshte me efekt domethenes ne mjedisin e zones.

**Ndotja e tokes** Ndotja e tokes si rezultat i rrjedhjeve te ndryshme gjate ngarkimit dhe shkarkimit te automjeteve apo ne rast te emergjencave te mundshme nga avarite ne sistem; Sistemi i transportimit dhe ngarkim shkarkimit eshte i mbyllur dhe mundesite e derdhjeve ne mjedis te lendes gjate procesit nuk egzistojne. Sistemi i terminalit te shkarkimit eshte i pa shtruar me beton ose me asfaltobeton, si rrjedhoje mund te kete ndotjke te tokes, ne raste te derdhjes se lendes se cimentos ne mjedis. Kamionet jane veteshkarkues dhe materiali i granilit terhiqet vete nga sistemi i sillozes se makinerise. Minimizimi i ndikimit ne mjedis lidhet me shkallen e trajnimit dhe ndergjegjesimit te punonjesve te kompanise per te mos lejuar furnizuesit apo cdo firme kontraktuese qe siguron furnizimin me lende te pare, te shkaktoje shkarkim te lendes se pare ne

toke. Gjithashtu sipërfaqja e tokës ku automjetet kryejnë ngarkimin dhe shkarkimin e lëndës së parë dhe produktit nuk është e betonuar dhe ekziston mundësia e ndotjes së tokës nga shkarkimet në mjedis. Automjetet dhe makineritë duhet të jenë të kolauduara nga Qendra e Kontrollit Teknik të Automjeteve. Mundësia e ndotjes nga rrjedhjet është pothuajse zero. Automjeteve duhet të kryhet pastrimi në mënyrë periodike për të mos mbartuar bitum ose papastërti të tjera gjatë transportit në zonat urbane dhe me rrugë të asfaltuara. Shkarkimi në tokë i elementeve të demshëm për mjedisin, shkakton ndotje serioze në mjedis, ndaj rekomandohet që aktivitetet të jenë të paisura me masa mbrojtëse dhe të shtrojnë sipërfaqet ku ato veprojnë. Ndotja e tokës, ndikon edhe në ndotjen e ujërave nëntokësore.

### **Ndotja e ajrit**

Ndotja e ajrit vjen nga pluhuri i granilit dhe reres të ekspozuara në ambiente të hapura, si dhe nga aktiviteti i ngarkimit e shkarkimit të materialit. Transporti i materialit shkakton gjithashtu pluhura në mjedis, ndonëse rekomandohet lagësia e sheshit të kantiereve. Procesi i punës së impiantit nuk përfshin procese të përdorimit të lëndës djegëse dhe nuk ka çlirime të gazeve të demshme për mjedisin. Përsa i përket zhurmave, ato janë të ndjeshme vetëm brenda ambienteve të fabrikës dhe nuk janë problem për mjedisin e jashtëm dhe fqinjët.

### **Mbetjet e ngurta**

Mbeturinat e ngurta vijnë nga: Aktiviteti human, mbetje urbane të plastikës, qelqit, metaleve etj të cilat janë të riciklueshme dhe do të hidhen në konteneret e mbetjeve urbane të zonës. Nga aktiviteti vlerësohet të ketë mbetje të ngurta nga ambalazhet e produktit, si plastmas, leter, karton paleta druri. Përsa i përket materialit të demtuar, ai mund të rifutet në procesin e fabrikës dhe të ripaketohet, ndërsa ambalazhet e tyre, hidhen në konteneret e mbetjeve të ngurta të zonës.

## **MASAT KRYESORE LEHTESUESE**

Masat lehtësuese që duhet të merren gjatë zhvillimit të aktivitetit . Nga vlerësimet shkarkimet e prishme në mjedis janë relativisht të ulëta dhe nuk përbejnë problem serioz për mjedisin.

a. Megjithatë përparësitë që ka ky aktivitet, duhet të tregohet kujdes në menaxhimin dhe mbajtjen nën kontroll të kushteve teknike për të minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet. Masat që duhen konsideruar për të minimizuar ndikimin në mjedis janë:

b) Duhet të tregohet kujdes në respektimin rigoroz të kushteve teknike në objekt për të reduktuar mundësitë e avarive gjatë punës.

c) Parandalimi i shkarkimeve të lëndës së parë në mjedis.

d) Lidhur me mbetjet e grumbulluara të menaxhohen në bashkëpunim me subjekte të licencuara ose me subjektin e grumbullimit të mbetjeve urbane.

e) Sasia depozituese e inerteve të mos i kalojë volumet e parashikuara në mënyrë që situata të jetë e kontrollueshme dhe të demtojë peizazhin.

f) Punonjësit të jenë të trajnuar paraprakisht dhe të jenë vazhdimisht në mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjatë proceseve të punës. Punimet e mirembajtjes të kryhen në përputhje me kushtet teknike të punës.

g) Të mbillet një brez pemesh të larta përgjatë murit rrethues të pronës, në mënyrë që të reduktojë impaktin në peizazh.

h) Të aplikohet lagia e shesheve ku qarkullojnë automjetet.

i) Të ndërtohet një vaske dekantimi për ujërat e përdorur.

j) Të orientohen ujërat e rreshjeve dhe të larges në vasken e dekantimit

### **Mbetjet dhe Shkarkimet për asfalto betonin**

**Shkarkime në ujë** Shkarkime në ujë nuk do të ketë.

**Mbeturinat e ngurta** që do të dalin nga impianti do të grumbullohen në një zonë jashtë dhe nuk do të kemi shkarkime në ujë.

**Shkarkimet në ajër** Shkarkimet në ajër do të kemi gjatë operacioneve të punimit. Nga impiante të tilla dalin gaze të rrezikshme si CO<sub>x</sub>, SO<sub>x</sub>, NO<sub>x</sub>, etj, si edhe grimca të ndryshme, të cilat do të dalin nga impianti, si pasojë e përpunimit të bitumit dhe lëndëve të tjera inerte. Por impianti është i pajisur me filtra, të cilat janë shumë cilësor.

**Zhurma.** Zhurma gjatë procesit të punës së kompleksit do të ketë. Në kohën e funksionimit të tij.

**Lëkundje** Lëkundje nuk do të ketë, sepse pajisjet lëvizëse janë shumë të pakta në numër dhe me fuqi të ulët dhe me konstruksione, që garantojnë punë në ekuilibër të plotë.

**Nriçimi** Nriçimi që do të përdoret gjatë ditës është drita e diellit dhe meqenëse impianti do të punojë 24 orë, natën do të përdoret ndriçimin elektrik. Nxehtësi Nxehtësi nuk çlirohet gjatë procesit të punës.

**Rrezatim** Rrezatim nuk ka gjatë përdorimit të impiantit

**Vibracione.** Vibracionet e lindura prej shoshitjes në pajisjet teknologjike janë të amortizuara qysh në dalje për shkak të funksionimit bashkëkohor të pajisjeve.

Subjekti prodhon asfalt me baze acide dhe bazike, me mpiksje të shpejta dhe të ngadalta. Këto prodhime janë të certifikuara nga drejtorja e rrugëve, me ndikim minimal në ambient dhe plotësojnë të gjitha normativat e Bashkimit Europian.

Asfalti është lidhja e bitumit me ujë. Pamja e tij është e kafe e eret me viskozitet të ngjashëm me qumështin. Ato përdoren në sektorin e rrugëve. Në sektorin e rrugëve, ato përdoren si shtresa ngjitesë, si dhe për shtrimin e rrugëve me penetrim. Materialet e përdorura kanë rezistencë të lartë

